



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranë - Primes, Në Datë: 03-06-2010			
Nr. i Urgentit / Urgjencës	Numri/Broj	Shitje	Vlera / Vlerësimi
	04-013/1582	-	-



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika c, nenit 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës “Gazeta Zyrtare nr 28/08” dhe në bazë të nenit 22,2 të Statutit të Komunës o2. nr. 013/5165 të datës 18.11.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2010 aprovon këtë:

## V E N D I M

PËR NDARJEN E DY TROJEVE NË SHFRYTËZIM PA TË DREJTË TJETËRSIMI PËR NDËRTIMIN E SHTËPIVË TË BANIMIT PËR ILFAN DHE ISMAIL ALILI PËR TË KTHYERIT NË RADIVOJC

### Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë NDAN pasurinë e pa luajtshme (tokën), pasuri publike e Komunës së Vitisë, e cila evidentohet në ngastrën /njësinë kadastrale nr 378 – 4 e cila është pjesë e parcelës 378-1, lloji i pronës parcelë, zona rurale, me kulturë bujqësore në vendin e quajtur “slanishte” me sipërfaqe prej 500m<sup>2</sup>, Komuna Kadastrale Radivojc, për ndërtimin e shtëpive për banim, dy qytetarëve familjar nga Radivojci Ilfan dhe Ismail Alili të cilët dëshirojnë të kthehen të jetojnë në Radivojc të Komunës së Vitisë.

Toka nga paragrafi 1 i këtij neni ju ipet në shfrytëzim Ilfan dhe Ismail Alilit pa të drejtë tjetërsimi (shitje, dhënies me qira, dhënies në shfrytëzim personave të tjerë etj).

### Neni 2.

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit pa të drejtë tjetërsimi të pasurisë së pa luajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën e Programit për të Drejtat Civile në Kosovë CRP/K i cili është partner implementues i UNHCR-it e sidomos motivit humanitar.

### Neni 3

Mjetet financiare për ndërtimin e këtyre objekteve të banimit do të sigurojnë agjensionet e ndryshme ndërkombëtare për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara, ndërsa për ndarjen e lokacionit (trojeve) për ndërtim do të kujdeset Komuna e Vitisë.

### Neni 4

Pas ndërtimit të shtëpive për familjen Ilfan dhe Ismail Alili, këto familje duhet të vendosen në shtëpitë e ndërtuara. Nëse nuk vendosen në afat prej 12 muaj në shtëpitë e ndërtuara, këto shtëpi kalojnë në pronë komunale dhe me këto shtëpi menaxhon Komuna e Vitisë.

### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

### Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dërgohet:

1. Palëve,
2. Drejtorisë për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër
3. Arkivit



KRYETARI I KUVENDIT

Skenderbe Hebibi